



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ
(PROJEKT)

(Nr. ____, datë ____ 2019)

**“PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.10463, DATË 22.09.2011 “PËR MENAXHIMIN E
INTEGRUAR TË MBETJEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 38, shtohen pikat 38/1, 38/2, 38/3, 38/4 dhe 38/5 me këtë përmbajtje:

38/1 “Plastik” është një polimer të cilit mund t’i jenë shtuar aditivë apo substanca nga lëndë të tjera, dhe i cili është i aftë të kryejë funksionin kryesor lidhës të komponentit strukturor të një qeseje mbajtëse.”

38/2 “Qese plastike mbajtëse” është qesja mbajtëse, transportuese me ose pa vesh prodhuar nga plastika, e cila jepet në pikat e tregtimit apo shpërndarjes të mallrave ose produkteve.”

38/3 “Qese e lehtë plastike mbajtëse” është qesja plastike me trashësi për çdo anë, me të vogël se 50 mikron.”

38/4 “Qese shumë e lehtë plastike mbajtëse” është qesja plastike me trashësi për çdo anë, me të vogël se 15 mikron.”

38/5 “Qese plastike mbajtëse oxo-degradueshme ose oxo-biodegradueshme” është qesja plastike mbajtëse e prodhuar nga materiale që përfshijnë aditivë të cilët katalizojnë copëzimin e materialit plastik në mikro-fragmente.”

38/6 “Qese plastike mbajtëse higjeno-sanitare” është qesja plastike mbajtëse apo transportuese pa vesh e cila shërben për grumbullimin, paketimin dhe/ose transportimin e mbetjeve”.

Neni 2

Në nenin 29, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Me përjashtim nga sa parashikohet në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, ndalohej përdorimi, hedhja në treg, prodhimi, importimi, apo futja në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, qeseve të lehta plastike mbajtëse, qeseve shumë të lehta plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme sipas përcaktimit të këtij ligji. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, përcakton masa të hollësishme për zbatimin e kësaj pike.

Neni 3

Në nenin 62, pas pikës 25 shtohet pika 25/1 dhe 25/2 me këtë përmbajtje:

“25/1. Çdo person, që hedh në treg, prodhon, importon, apo fut në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, qese të lehta plastike mbajtëse, qese shumë të lehta plastike mbajtëse, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 29, të këtij ligji, dënohet me gjobë, në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.”

“25/2. Çdo person që përdor në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, qese të lehta plastike mbajtëse, qese shumë të lehta plastike mbajtëse, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 29, të këtij ligji, dënohet me gjobë, në vlerën nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 100 000 (një qind mijë) lekë.”

Neni 4

Dispozitë Kalimtare

1. Subjektet të cilat para hyrjes në fuqi të këtij ligji, prodhojnë, importojnë, apo hedhin në treg, në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, qese të lehta plastike mbajtëse, qese shumë të lehta plastike mbajtëse, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-

biodegradueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 29 të këtij ligji, ndalojnë ushtrimin e këtyre veprimtarive brenda datës 1 Shkurt 2020.

2. Subjektet të cilat fusin apo përdorin në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, qese të lehta plastike mbajtëse, qese shumë të lehta plastike mbajtëse, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 29 të këtij ligji, ndalojnë ushtrimin e këtyre veprimtarive brenda datës 1 Qershor 2020.
3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerr aktin nënligjor në zbatim të pikës 3, të nenit 29 të këtij Ligji.

Neni 5 Shfuqizime

1. Çdo dispozitë ligjore dhe akt nënligjore që bien ndesh me përcaktimet e këtij ligji, shfuqizohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KUVENDIT

GRAMOZ RUÇI

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.10463, DATË 22.09.2011 ‘PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE’”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përdorimi i pakufizuar i produkteve plastike një përdorimshe sot, paraqet sfidën më të madhe mjedisore me të cilën ndeshet planeti jonë. Qeset plastike kanë ndikim negativ në mjedis që nga fillimi dhe deri në mbylljen e ciklit të përdorimit të tyre. Për më tepër në ekonomi demet e shkaktuara nga plastika janë shumë të mëdha duke ndikuar drejtpërsëdrejti në turizmin, transportin detar apo peshkimin. Mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njeriut nga pasojat e përdorimit të këtij produkti janë në politikën e qeverisë për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm si dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe në veçanti nxitjen e zhvillimin e ekonomisë së turizmit dhe promovimit të përdorimit me efikasitet të burimeve natyrore.

Bazuar në kompetencat që ligji i jep, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit merr përsipër të propozojë një plan masash për reduktimin, parandalimin deri në ndalimin e plotë të hedhjes në treg të qeseve plastike mbajtëse. Ndalimi i përdorimit të qeseve plastike mbajtëse, si një masë për parandalimin e mbetjeve, pritet që të sjell një reduktim të sasisë së qeseve plastike të hedhura ngado në mjedis, do të sjell reduktim të kostos së menaxhimit të tyre si dhe minimizim të ndikimit në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Objektivi i këtij projektligji është ndalimi i përdorimit të qeseve plastike mbajtëse duke synuar që pas datës 1 Qershor 2020, në Shqipëri nuk do të prodhohet, importohet dhe as nuk do të përdoren qese plastike mbajtëse, duke e bërë Shqipërinë vendin e parë në Europë pa qese plastike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2019 dhe në përputhje me politikën e qeverisë për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm si dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe në veçanti nxitjen e zhvillimin e ekonomisë së turizmit dhe promovimit të përdorimit me efikasitet të burimeve natyrore.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet këtij projektligji do të garantohet mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njeriut nga pasojat e përdorimit të këtij produkti, reduktim të sasisë së qeseve plastike të hedhura ngado në mjedis, e cila do të sjell reduktim të kostos së menaxhimit të tyre si dhe minimizim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Kërkimet vlerësojnë se më shumë se 79% e produkteve plastike, (sidomos ato një përdorimëshe) janë të depozituara në landfille ose në ambiente të hapura, ndaj edhe përpjekjet për veprim nga shumë qeveri janë fokusuar kryesisht në marjen e masave për reduktimin e produkteve plastike një përdorimëshe e sidomos në reduktimin e qeseve plastike, të cilat shkaktojnë një ndotje jo vetëm në dukje në mjedis, por edhe me efekte në shëndetin e njeriut, ndikim financiar në ekonomi dhe në ekosistemet mjedisore.

Sipas një vlerësimi të bërë nga NALAS në rajonin pilot të “Bregdetit të Adriatikut”, i cili përfshin 9 bashki nga katër shtete: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Mali i Zi për të vlerësuar impaktin ekonomik të lidhur me pastrimin e plazheve dhe hedhjet e paligjshme të mbetjeve, humbjet në të ardhura për shkak të turistëve që nuk kthehen më, rezulton se për vitin 2015 ky

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.10463, datë 22.09.2011 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’”, të ndryshuar.

rajon ka humbur të paktën 34,450,365 Euro. Për më tepër, çdo vit shpenzohen 1,556,550 Euro për pastrimin e mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme dhe 2,018,280 Euro për pastrimin e plazheve.

Nga një vlerësimi i bërë në kuadër të Strategjisë Kombëtare – Menaxhimi i Mbetjeve nga Plastika dhe Riciklimi¹, në vitin 2016 është vlerësuar se në Shqipëri përdoren 6 – 9 kg/person/vit artikuj plastike me një përdorim, kryesisht qese plastike mbajtëse. Duke vlerësuar peshën e një qeseje si dhe faktin se vlera mesatare në Shqipëri që një person përdor mesatarisht rreth 3 qese në ditë, mund të vlerësojmë se për një popullsi rezidente prej afërsisht 3,000,000 banorë sasia e qeseve plastike është rreth 3.2 miliard qese në një vit ose afërsisht 26,280 ton/vit.

Në kuadër të një projekti pilot “Menaxhimi i Mbetjeve Detare në Shqipëri” janë bërë matje sezonale në grykderdhjet e dy prej lumenjve kryesor të vendit (për nga numri i zonave të banuara dhe popullsisë që këta dy lumenj përshkojnë), Lumi Bunë dhe Ishëm. Nga observimi i këtyre dy lumenjve ka rezultuar se plastika në përgjithësi dhe qeset plastike në vecanti përbëjnë mbetjen kryesore që depoziohet në bregdet nëpërmjet rrjedhjave lumore. Rezultatet e observimit në një sipërfaqe prej 100 m², në deltën e Bunës ka rezultuar se nga totali prej rreth 46 kg mbetje që gjendeshin të depozitura rreth 42.3 kg ishin mbetje plastike/polystyrene (kryesisht qese plastike mbajtëse). Po të njëjtat të dhëna vijnë edhe nga matjet në deltën e Ishmit. Në një sipërfaqe prej 100 m², nga totali prej rreth 84.5 kg mbetje që gjenden të depozitura në Kepin e Rodonit rreth 52,4 kg janë mbetje plastike/polystyrene (kryesisht qese plastike mbajtëse).

Këto të dhëna tregojnë se qeset plastike mbajtëse përbëjnë një prej ndotësve kryesorë të mjedisit shqiptar si në shtrirje territoriale ashtu dhe në sasi, duke treguar se masat për të gjetur një zgjidhje definitive janë sa të nevojshme, të justifikuara aq edhe emergjente.

Ndërhyrjet ligjore të bëra në vitin 2011, nëpërmjet nxjerrjes së ligjit nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij nuk patën impaktin e dëshiruar. Fillimisht detyrimi që

¹ National Strategy “Plastic Waste Management and Recycling in Albania”, 2016. UNIDO-UNEP Programme on Resource Efficient and Cleaner Production (RECP)

pas datës 1 Janar 2013, nuk lejohet prodhimi dhe tregtimi i qeseve plastike jo biodegraduese më të vogla se 30 µ trashësi dhe më pas ndryshimet e akteve nënligjore në 2018 duke vendosur rregulla të tjera mbi përmbajtjen e prodhimit, informacionin e stampuar dhe trashësinë e qeseve, sollën përmirësim të situatës por jo atë të dëshiruar.

Në vend ka rreth 62 kompani që prodhojnë produkte plastike dhe vetem 25 prej tyre prodhojnë qese plastike një përdorimshe. Sic deklaroi Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit pas hyrjes në fuqi të VKM-së, pas Korrikut të 2018, prodhimi i këtyre qeseve plastike nga këto kompani është ulur me 30%. Kontrollat e inspektoriatit tregojnë se vetem 70% e këtyre kompanive plotësojnë kriteret e VKM-së.

Ndonëse janë arritur disa rezultate, parashikimet sipas VKM Nr. 232, datë 26.04.2018 për qese plastike mbajtëse nuk kanë rezultuar të mjaftueshme; pas përdorimit të tyre të pare, ato hidhen si mbeturina ose mund të përdoren për të transportuar mbetjet familjare drejt kontenerëve, në pikat e grumbullimit kolektiv të mbeturinave në cdo lagje. Për shkak të menaxhimit ineffektiv, një sasi shumë e vogël e tyre, e cila ka trashësi dhe nuk është e ndotur nga mbetjet, mund të hyjë përsëri në cikël për t'u ricikluar, ndërkohë që pjesa më e madhe e tyre përfundon në lumenj, vendepozitime të hapura, landfille, apo në incinerator për djegie.

Në dokumentin e publikuar nga UN Environment 2018, "Plastikat një Përdorimshe – Udhërefyesi drejt Qëndrueshmërisë" raportohet se: Në Afrikë ka më tepër se 25 vende të cilat e kanë ndaluar plotësisht prodhimin dhe përdorimin e qeseve plastike dhe më tepër se gjysma e tyre kanë filluar ta zbatojnë atë përgjatë viteve 2014 – 2017 (Kenia, Ethiopia, Egypeti, Mali, South Afrika etj.) Në Azi forma e ndalimit të përdorimit të qeseve plastike është e kombinuar, ka vende të cilat përdorin taksat mbi qeset plastike, ndërkohë që ka edhe vende të cilat e kanë ndaluar plotësisht përdorimin e qeseve plastike.

Në Europë në përgjigje të direktivës 2015/720 për të arritur një reduktim të qëndrueshëm të numrit të qeseve të holla plastike të përdorura për person në 2025, vendet kanë zgjedhur që të marrin masa nga ndalimi i plotë (sic është psh Italia dhe Franca) deri në marrëveshje vullnetare dhe kontrata me sektorin privat

sic është Austria. Në Francë që nga viti 2016 nuk lejohen qeset e holla plastike < 50µ dhe kjo politikë është zgjeruar më tej në 2017 ku u ndalua prodhimi, shpërndarja dhe shitja e të gjitha qeseve plastike me përjashtim të qeseve të kompostueshme. Në Itali ndalohet përdorimi i të gjitha qeseve plastike më të holla se 100µ me përjashtim të qeseve plastike që ripërdoren, gjë që solli në vitin 2011 një reduktim të përdorimit të qeseve plastike me më shumë se 55%. Në krahinën e Katalonjës është miratuar ligji për ndalimin e të gjitha qeseve plastike një përdorimshe përfshirë dhe ato të biodegradueshme.

Sa më lart, që ligji të realizojë plotësisht qëllimet për të cilat është miratuar dhe zgjidhjet e ofruara për menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë, të garantojnë sa më tepër rezultate positive, janë propozuar ndryshimet e parashtruara në projektligjin e hartuar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, si ligj kuadër.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk përfron asnjë direktivë apo rregullore të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 të këtij projektligji parashikohet shtimi i pikave 38/1, 38/2, 38/3, 38/4, 38/5 dhe 38/6, ku përcaktohen përkufizimet e termave “Plastik”, “Qese plastike mbajtëse”, “Qese e lehtë plastike mbajtëse”, “Qese shumë e lehtë plastike mbajtëse”, “Qese plastike mbajtëse oxo-degradueshme ose oxo-

biodegradueshme” dhe “Qese plastike mbajtëse higjeno-sanitare” të cilat janë përkufizime të marra dhe të përshtatura me kuadrin ligjor evropian.

Në nenin 2 të këtij projektligji parashikohet shtimi i pikës 3 në nenin 29, ku përcaktohet ndalimi i prodhimit, importimit, hedhja në treg, futja apo përdorimi në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, qeseve të lehta plastike mbajtëse, qeseve shumë të lehta plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme. Këshilli i Ministrave do të përcaktojë masat e hollësishme për zbatimin e kësaj pike. Duke marr shembull vetëm brigjet e lumenjeve dhe vijat bregdetare, shihet dukshëm që janë të mbushuar me mbetje plastike, të cilat jo vetëm prishin peizazhin, por sjellin dëmtim të habitatit ujor, ku shumë shpendë janë drejt zhdukjes nga dehidratimi dhe uria, si pasojë e gëlltitjes të plastikës në vend të ushqimit. Studimet tregojnë që dëmi i përgjithshëm ekonomik në ekosistemet detare i shkaktuar nga plastika kushton të paktën 13 biljon dollar në vit.

Në nenin 3 të këtij projektligji parashikohet shtimi i pikës 25/1 dhe 25/2, në nenin 62, ku parashikohet si kundravajtje administrative dhe dënimi me gjobë, nëse nuk zbatohet përcaktimi i kryer në pikën 3 të nenit 29.

Në nenin 4 të këtij projektligji parashikohen dispozitat kalimtare në të cilat përcaktohen afatet deri kur do të vazhdojë veprimtaria e subjekteve të cilat prodhojnë, importojnë, hedhin në treg, magazinojnë, përdorin apo fusin në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike. Kjo kohë do të jetë e nevojshme që subjektet dhe banorët e Republikës së Shqipërisë të informohen dhe ndërgjegjësohen me nismën e ndërmarrë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen:

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe institucionet e saj të varësisë
2. Njësitë e Vetqeverisjes Vendore.
3. Institucionet e tjera, fusha e përgjegjësisë e të cilave lidhet me menaxhimin e integruar të mbetjeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e projektligjit kanë kontribuar ekspertë të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Projektligji do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministrinë për Marrëdhëniet me Parlamentin si edhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk sjell shpenzime shtesë buxhetore, pasi strukturat që do të angazhohen për zbatimin e këtij vendimi, janë aktualisht të ngritura dhe funksionale.

PROPOZUESI

MINISTRI

BLENDI KLOSI

Shënime

1. Lloji i shkrimit në të gjithë dokumentin është “*Times New Roman*”, madhësia e shkrimit 14, hapësira mes rreshtave 1.
2. Titulli i dokumentit “Relacion për ...lloji i projektaktit...titulli i projektaktit” dhe titujt e rubrikave shkruhen me shkronja të mëdha “*Bold*” me hapësirë 1 mes rreshtave, e vendosur në qendër.
3. Shkrimi në “*Footer*” është i madhësisë 11.